Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1055

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "KROSA traffic signs" SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit-Ri-tender" me numër të prokurimit 657-23-3118-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Viti, më 13/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Refuzohet**, si e pabazuar ankesa e "KROSA traffic signs" SH.P.K. me nr. 2023/1055 , e datës 26/12/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit-Ri-tender", me numër të prokurimit 657-23-3118-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Viti

2.Vërtetohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues – Komuna Viti lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.04.2023, Komuna Viti në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit-Ri-tender" me numër të prokurimit 657-23-3118-1-2-1. Ndërsa me datën 08.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë "Limit L & B SH.P.K"

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 10,000.00 €.

Me 12.12.2023, OE "KROSA traffic signs" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "KROSA traffic signs" SH.P.K., me nr. 1055/23 lidhur me aktivitetin "Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit-Ri-tender" me numër të prokurimit 657-23-3118-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "KROSA traffic signs" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim**:**

AK-KOMUNA VITI, ne aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit, me nr. prokurimi 657-23-3118-1-2-1. AK nuk i ka vlerësuar ofertat konform kritereve të njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit, pasi që i njëjti AK e ka rekomanduar për kontratë OE "LIMIT L&B, i cili OE është i papërgjegjshëm, sipas kritereve te dosjes dhe se i njëjti ka qene dashtë të anulohet e jo të rekomandohet për kontratë. AK ne kriteret e dosjes ka kërkuar kritere të natyrës se projektit e qe OE nuk i ka përmbushur dhe se ka qene dashtë të eliminohet nga ky aktivitet. Kriteret e kërkuara te Dosjes tek Kapaciteti teknik dhe profesional janë : Kapaciteti teknik dhe profesional 1.OE ose Grupi i OE, të sjell Kontrata të projekteve për furnizime të ngjashme, minimum sa vlera e Unifikimit të projektit. 2. a.) Mjetet e punës ne dispozicion, vetura dhe mjete transporti për kryerjen e punëve b.) Pajisje të punës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimi për shenjëzimin vertikal dhe horizontal 3. OE te disponoj një certifikatë ISO standard 9001 2015 4. Lista e stafit min 10.te përmbaj emrat dhe mbiemrat dhe profesioni punëtorëve te dorëzohet (dhe vuloset nga OE, duke bashkangjitur kontrata ose para kontratat; Një inxhinier të komunikacionit master, se paku 2 dy(2) punëtor të certifikuar për mbrojte të shëndetit (dhe siguri në punë dhe së paku dy(2) punëtor të trajnuar për mbrojtje nga zjarri. Lidhur me kriteret e lartshënuara (të kërkuara si ne DT), ne si OE gjate qasjes qe kemi pasur ne dosjen e tenderit te OE se rekomanduar kemi ardhë ne konkludim, se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm për faktin se: Te kriteri te pika 2.a) të sjellët dëshmi se paku një (1) kombi, OE i rekomanduar te ky kriter nuk e ka ofruar kombi, por e ka ofruar pikap (Renault Kango), qe nuk e plotëson kriterin e dosjes se tenderit (provë sipas numrit të sasisë dhe hulumtimit ne google).ROVE: 002 DESHMITE - PAISJET, AUTORIZIMET.pdf . Te kriteri i kërkuar për pajisjen për sigurinë ne komunikacion: Rimorkio me drita sinjalizuese për Siguri ne komunikacion, te ky kriter OE i rekomanduar nuk e ka ofruar dëshminë — librezën e qarkullimit të rimorkion edhe pse kjo kërkohet sipas ligjit ne fuqi, që është ne fuqi e që dëshmohet se mjetet që lëvizin ne rastin ne fjalë rimorkio duhet të këtë regjistrim (librezë për qarkullim ne

komunikacion). OE i rekomanduar ka një marrëveshje me “FAMIS CO”, mirëpo nuk e ka te regjistruar. Pra, OE i rekomanduar nuk e disponon rimorkion e regjistruar siç kërkohet ne Republikën e Kosovës dhe nuk ka libreze qarkullimi siç e cekem me lartë, por ka një DUD Doganor, sipas marrëveshjes se bashkëpunimit me “FAMIS CO”. Pra, OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar të DT dhe NJK-se (dhe duhet të eliminohet e jo të rekomandohet nga AK për këtë aktivitet. Te kriteri "a. Makinë për lakimin e metaleve profileve (marrëveshje për bashkëpunim NPTSH LIMIT L & B dhe Gyner Haci B.I). Pra bazuar ne këtë marrëveshje dëshmohet se OE i rekomanduar nuk e disponon këtë pajisje pasi qe nuk e ka ofruar sipas kriterit të DT-së "a. Makinë për lakimin e metaleve profileve", por ne DUD-in e bashkangjitur ne dosje shkruan (citim): Makinë prerëse që përdoret për punimin e llamarinës dhe profileve metalik, për prodhimin e dyerve dhe dritareve, ndërsa ne DT- është kërkuar decidivisht për SINJALIZIM VERTIKAL - a. Makinë për lakimin e metaleve profileve . Pra, OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar të DT dhe NJK-se (dhe duhet të eliminohet e jo te rekomandohet nga AK për këtë aktivitet. Edhe te kriteri tjetër i Dosjes: b) Makine për prerje rrethore te metaleve (aluminit), edhe te ky kriter siç është kërkuar ne DT dhe NJK, dëshmohet se OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar për arsye se kriteri i DT-së është "Makinë për prerje rrethore të metaleve (aluminit)," kurse OE i rekomanduar e ka ofruar DUD-in me përshkrim: Veala-Makinë për punimin e çdo materiali nëpërmjet zhvendosjes se materialit, nëpërmjet proceseve me rreze Ilazer apo me rreze foton apo me rreze te tjera drite, nëpërmjet proceseve me ultra tinguj. Andaj, nga përshkrimi i paraqitur ne DUD, automatikisht vërtetohet se nuk është makina e ofruar siç është kërkuar ne kriter: Makinë për prerje rrethore të metaleve (aluminit), por është ofruar një pajisje tjetër që nuk ndërlidhet me natyrën e punës se kërkuar dhe kjo dëshmohet se OE nuk e plotëson edhe këtë kriter të DT-së dhe mos plotësimi i kritereve e bën ofertën e papërgjegjshme sipas nenit 59.4 të LPP-së, e që thotë (citim): Autoriteti Kontraktues duhet te rekomandoj për kontratë një Operator Ekonomik që i plotëson kriteret e kërkuara të njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit. Andaj, bazuar ne nenin (59.4 te LPP-se) të lartshënuar AK duhet të eliminoj OE e rekomanduarpasi qe i njëjti është i papërgjegjshëm Pra, OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar të DT dhe NJK-se dhe duhet të eliminohet e jo të rekomandohet nga AK për këtë aktivitet.

Te kriteri I DT-se: c. Makine (gërshëre) për prerjen e metaleve, po ashtu edhe te ky kriter OE i rekomanduar nuk e ka dëshmuar ne dosjen e tij te tenderit se e disponon makinën për prerjen e metalit(sipas specifikimit teknik min. 2 mm), kurse OE i rekomanduar ka ofruar gërshërë dore të cilat nuk mund të përdoren për asgjë me shumë se për tekstil, për shkak se vlera e gërshërëve që i ka ofruar OE “LIMIT L& B” është 13.50 € (sipas faturës se bashkangjitur me nr.213254 të cit. 23.02.2023) nga vet OE “LIMIT L&B”. Po ashtu vlen të ceket se te marrëveshja — kontrata e qerase e datës 27.07.2015 e nënshkruar ne mes të Qiradhënësit Muharem Haci, person fizik, dhe Qiramarrësi NPSH NUR & CELIK, ku ne këtë marrëveshje ceken APKAN40 T dhe Gërshërë për prerjen e llamarinës deri ne 4 mm, por sipas marrëveshjes ne fjalë askund nuk ceket se është qiramarrës OE i rekomanduar “LIMIT L&B”.Pra, qiramarrësi dhe qiradhënësi janë persona të tjerë të cilën nuk kanë të bëjnë asgjë me këtë kontratë, mund ta vërtetoni dokumentin e bashkangjitur ne dosje.Pra, kjo e dëshmon se OE ka tentuar te lajthit AK-ne me emra të pajisjeve të cilat nuk i ka prezantuar dëshmitë (marrëveshje, DUD dhe faturë) e qe ndërlidhën me OE e rekomanduar “LIMIT L&B”.

Pra, OE I rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar të DT dhe NJK-se dhe duhet të eliminohet e jo të rekomandohet nga AK për këtë aktivitet.. PROVE:DESHMITE PER PAJISJET E BASHKANGJITURA NE KETE ANKESE.

Te kriteri d. Makinë për printimin e shenjave të trafikut, po ashtu edhe te ky kriter i dosjes nuk e ka dëshmuar OE i rekomanduar "LIMIT L&B", se e plotëson kriterin e dosjes dhe NJK-se, por ka ofruar një makine e cila nuk është e natyrës se kërkuar, e qe po ua sqarojmë përmes DUD-it të bashkangjitur ne dosje, ku te përshkrimi i makinës ceket: Printer qe lidhet me një kompjuter ose ne rrjet, Makina printimi MIMAKI, CJV300-160 me nr. serik AV16B162.

Lidhur me këtë DUD të pajisjes se lartcekur gjate qasjes që keni marr ne AK e keni vërtetuar se i njëjti DUD nuk i disponon përshkrimet e një DUD-i të kompletuar sipas Legjislacionit ne fuqi, ku vërehet me sy se këtij DUD-I I mungojnë shumë të dhëna që e bëjnë të dyshimtë, dhe gjeni të bashkangjitur si Provë DUD-in, ku mund ta krahasoni me DUD-a të tjerë dhe do ta vërtetoni menjëherë se OE ka prezantuar një DUD të dyshimit e qe i njëjti duhet të vërtetohet pranë organeve kompetente, pasi qe askund nuk ceket se është ne pronësi të OE "LIMIT I-J&B", po ashtu nuk ka përshkrim të çmimit, përshkrim të sasisë, nuk gjendet emri i shpediterit, nuk gjendet vula eshpedicionit, nuk gjendet as shifra e shpedicionit dhe nuk gjendet as emri i pronarit

PROVE: DUD-i i cili dyshojmë se është ndërhyrë ne te dhe i njëjti duhet të vërtetohet nga organet kompetente. Pra, OE I rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar të DT dhe NJK-se dhe duhet të eliminohet e jo të rekomandohet nga AK për këtë aktivitet. Pra, OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar të DT dhe NJK-se dhe duhet të eliminohet e jo të rekomandohet nga AK për këtë aktivitet.

Te kriteri f. Autorizim origjinal (apo kopje e noterizuar) nga prodhuesi ose distributori për shenjat vertikale foljen reflektuese DG.

OE I rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar të dosjes për arsye se sipas marrëveshjes që ka ofruar ne dosje OE i rekomanduar ka prezantua një marrëveshje me një OE ne Republikën e Serbise D.o.o BOJA — Sombor, i cili OE nuk është prodhues i folis reflektuese DG, por as nuk është distributor për Foli reflektuese, edhe pse Distributori duhet te jete ne Republikën e Kosovës e jo të prezantohet kinse një distributor apo përfaqësues ne Serbi i cili nuk është prodhues i kësaj folie dhe kjo e dëshmon se OE I rekomanduar nuk e plotëson kriterin e DT-së : Autorizim origjinal (apo kopje e noterizuar) nga prodhuesi ose distributori për shenjat vertikale foljen reflektuese DG.

Sqarim: Nëse hulumtohet ne www.google.com i njëjti Operator D.o.o BOJA Sombor- Serbi, vërtetohet se nuk është prodhues i folis reflektuese, por merret me sinjalizim.Andaj, bazuar ne provat dhe dëshmitë e lartshënuar OE i rekomanduar "LIMIT L&B", nuk e plotëson kriterin e kërkuar të DT dhe NJK-se dhe duhet të eliminohet e jo të rekomandohet nga AK për këtë aktivitet.Te kriteri për Sinjalizim Horizontal: I. Se paku dy makina për sinjalizim horizontal me ngjyrë të thjeshte një komponentë sipas këtij kriteri kërkohen qe OE ti prezantoj (bashkëngjis dëshmitë) ne dosjen e tij se paku për 2 makina për sinjalizim horizontal, por OE I rekomanduar "LIMIT L&B", ka ofruar një makinë e cila disponon DUD-in doganor dhe është konform kriterit, mirëpo për makinën e dytë ka ofruar një marrëveshje me një kompani ne Serbi D.o.o BOJA — Sombor, ku sipas kësaj marrëveshje dëshmohet se nuk ka konzorcium por edhe siç dihet edhe nga përvoja se asnjë pajisje nuk ka mund të futet përmes doganës ne Kosovë, për të kryer shërbime të qerasë ne Republikën e Kosovës si ne rastin ne fjalë, por për shkak të pengesave që kanë ne shfrytëzim asnjë makinë nga Serbia deri me tani nuk ka operuar ne raste të tilla.Pra, kjo e dëshmon se edhe marrëveshja është e dyshimtë, dhe lirisht mund te themi se OE i rekomanduar e ka ofruar vetëm për mbulese që ti plotëson kriteret e Dosjes, duke e mashtruar AK-në, vetëm për tu shpërblyer me kontratë për tenderin ne fjalë.Edhe te ky kriter nuk

plotësohet kriteri i dosjes dhe ky OE mendojmë se e ka vene ne lajthitje AK-në. Poashtu edhe për ketë kriter OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e DT dhe NJK-së dhe duhet të eliminohet e jo te rekomandohet nga AK për ketë aktivitet.Poashtu lidhur me kriterin e DT-se : Te kriteri 3 1 dosjes është kërkuar: OE të disponoj një certifikatë ISO standard 9001 2015.andaj duke u bazuar ne dokumentet e prezantuara ne dosje, dëshmohet se OE i rekomanduar për Certifikatën ISO që ka prezantuar shihet si certifikate e dyshimtë. Pra, pse e themi të dyshimtë është se kemi tentuar ta verifikojmë përmes linkut e :https://eqsc-cert.orgpor nuk kemi mundur ta verifikojmë e qe po e paraqesim si me poshtë dëshminë që nuk mund të vërtetohet asgjë përmes linkut që është shkruar ne Certifikatën ISO.DESHMINGA INTERNETI: se Certifikata ISO nuk mund te verifikohetPo ashtu edhe AK ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim shkruan se nga kërkesa për sqarime qe ka pranuar Autoriteti Kontraktues nga Kompania e rekomanduar për Kontrate LIMIT L&B, nuk ka mund ta verifikoj dokumentin ISO 9001 2015, sipas linkut: https://eqscert.org/klient-te-certifikuar

Pra, edhe nga linku qe e ka dërguar OE LIMIT nuk e dëshmon se CERTIFIKATA ISO 9001 :2015 ESHTE VALIDE, por shihet se e dyshimit pasi qe te njëjtën përgjigje e ka dhënë edhe AK ne VENDIMIN E REFUZIUMIT Kjo qe shihet ne Vendim e dëshmon një gjë se Certifikata nuk është ne rregull dhe vet AK e ka pranuar ne këtë Vendim te Refuzimit. Poashtu, vlen të ceket se te Certifikata ISO, e Cila shihet si e dyshimtë pasi që të emri i Operatorit te vendosur ne Certifikate, pos emrit është e bashkangjitur edhe LLOGO (LIMIT L & B), e OE se rekomanduar dhe kjo është e dyshimtë për shkak deri me tani asnjë kompani nuk ka mundur të fut LLOGON e kompanisë ne certifikatën e cilësisë ISO 9001 2015.Me këtë certifikate ISO e cila dyshohet të mos jetë ne rregull, e bën Ofertën e OE "LIMIT L&B" është e papërgjegjshme, andaj AK ka qene dashtë ta eliminoj këtë OE, e jo ta rekomandoj për kontratë. Pasi që neni 59.4 i LPP-së e sqaron shume qartë, poashtu është përgjegjësi edhe e ZPP-së (Zyra e Prokurimit) qe për raste e dyshimta të bej verifikimin apo hulumtimin edhe përmes E-mailave qe i ka të futur ne Certifikate.Poashtu, pretendimi tjetër i yni lidhur me OE e rekomanduar, kemi hasur se ne dosjen e tij e ka bashkangjitur një AUTORIZIM nga EVELUX TECH, System Reflective Product, i cili autorizim është i datës 01.12.2014 me validitet 1 vit, e qe dëshmohet se ky autorizim ka pasur afat deri me date01.12.2015 ka pas validitet. Ku pas kësaj datë është e pavlefshme apo e skaduar autorizimi i bashkangjitur ne dosje.. Andaj mendojmë se me këto veprime OE i rekomanduar ka futur dokumente të skaduara duke tentuar të mashtroj AK vetëm që të rekomandohet për kontratë për këtë aktivitet.Pra, shihet haptazi tentimi qe ka bere OE "LIMIT L&B" për këtë tender me qëllimin e vetëm të përfitimit të tenderit jashtëligjshëm.Edhe kjo e dëshmon se nuk i përmbush kriteret e DT OE i rekomanduar "LIMIT L&B", dhe se nga AK ky OE duhet te eliminohet e jo te rekomandohet nga AK për këtë aktivitet.Poashtu, OE i rekomanduar (LIMIT L&B) ka ofertuar me çmime te ulëta, ku me këto çmime nuk ka mundësi as prodhuesi i pajisjeve për ta kompletuar këtë Project nuk ka mundësi të oferton me këto çmime absurd ashtu siç ka ofertuar OE "LIMIT L&B"., andaj me këto veprime OE i rekomanduar (LIMIT L&B), ka bere shkeljen e nenit 61 të LPP-së, duke manipuluar me çmime ne paramasen si ne pozicionet:16,17,18, 19,20, ka vendosur çmime jo normalisht të ulëta, e që me këto çmime nuk mund të kompletohet një Panel si ne foto, ku dihet se çmimi i panelit ne fjalë është minimum 3500 Q, e jo me çmim 45.00 € siç e ka vendosur apo mashtruar me këto çmime OE i rekomanduar "LIMIT L&B",Te bashkangjitur gjeni paramasen që e dëshmon se me çfarë çmime ka ofertuarAndaj me këto çmime AK ka qene dashtë të veproj sipas paragrafit 2, 3 dhe 4 te nenit 61 te LPP-se, e qe thotë: 2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: 2.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, te shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; 2,2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur 2.3 çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në

dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose 2.4origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe shpjegimeve që janë dorëzuar nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues konstaton se tenderuesi ka dorëzuar në shenim të mjaftueshëm të bazave të tenderit të tij, autoriteti kontraktues duhet të trajtojë tenderin e tillë në mënyrën e njëjtë siç i trajton edhe tenderët e tjerë. 4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin. DESHMI: Prova qe OE ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, për produktet që janë shume te shtrenjta Foto dëshmi për Panelit ndriçues me drita digjitale Led, që vërtetohet se nuk mund të kryhet ky PANEL NDRIÇUES me çmim 45.00 €, mund ta hulumtoni edhe tregun për këtë product..450CM PRA, AK- KUVENDI I KOMUNES VITI, nuk e ka respektuar nenin 108/A te LPP-se duke mos e respektuar paragrafin 10.2 te nenit 108/A të LPP-së, e qe thotë:O. Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:10.2.të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;Pra, mos respektimi i këtij neni 108A te LPP-se, na dëshmon se AK na ka diskriminuar ku ka bere shkeljen e nenit 7 te LPP-se, dhe duke mos i vlerësuar ofertat sipas nenit 59 të LPP-së, e qe automatikisht me mos plotësimin e kritereve te DT-se (pajisjeve), është shkelur neni 69 i LPP-së.Poashtu edhe çmimet jo normalisht të ulëta e dëshmojnë se OE ka ofertuar me çmime të cilat nuk mundet as lënda e pare të furnizohet as ne Kine pa montim e lere të montohet një pajisje (të cilës duhet ti bashkëngjiten edhe konstruksionet metalike, e te cilat kane një kosto shume të lartë), e qe se paku do të kushtoj me vlerë 3500 Euro, e kurrsesi të montohet me 45.00 Euro sa ka ofertuar OE i rekomanduar.Bazuar ne pretendimet e lartshënuara kërkojmë nga ju si OSHP që të merrni parasysh ankesën tonë si të bazuar ne fakte dhe prova."

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1, 6 , 7 , 59, 60, 61, 69, 72, 108Atë LPP –së, si dhe 28, 42, 39 te rregullores se prokurimit publik. Duke propozuar qe të aprovojë si të bazuar ankesën e OE "KROSA Traffic Signs" SHPK, dhe teanuloj vendimin e AK-së, i cili vendim është i pa bazuar ne kriteret e DT-se, dhe përmes kësaj ankese kërkojmë qe lënda te kthehet nerivlerësim, dhe gjate rivlerësimit te rekomandohemi për kontrate pasi qe ne si OE jemi i përgjegjshëm, ku i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara të Dosjes se tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: "Zyrtari prokurimit, Bazuar në nenin 108/A, pika 10.2 të LPP,AK merr këtë vendim pasi që Kompania "KROSA trafic signs" SH.P.K nuk ofron ndonjë dëshmi me të cilat i arsyeton pretendimet ankimore. Bazuar ne nenin 108/A paragrafi 6, ka shtyrë afatin e marrjes se vendimit.

Lidhur me pretendimet e juaja, ne ju keni drejtuar OE të rekomanduar, cili ka shpjeguar çështjet e ngritura, për të cilat OE ka ofruar dëshmi, edhe pse ky autorizim ka afat deri me 22 prill 2023 dhe nuk është vazhduar.

Shpjegimin lidhur me gërshërët prerëse e jap vetëm me një shpjegim, të cilin nuk e mbështet, pos arsyetimit se është ndërruar pronari nga Muharrem Haci tek Gyner Haci.

Për pretendimin lidhur me Makinën prerëse të profileve, del se ajo është makine prerëse edhe për prerjen e aluminit dhe profileve metalike për dyer dhe dritare.

Pretendimin lidhur me pikcap, se OE ofron një dëshmi me pronësi të tij.

Lidhur me verifikimin e ISO Standardit 9001 :2015, OE na ka dërguar një linkun:https://eqs-cert.org/klient-te-certifikuar/ i cili nuk është i qasshëm.

Për pretendimet e tjera, nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme, ndërsa lidhur me çmimin jo normalisht te ulët, të ofruar nga OE "LIMIT LB", keni një Vendim nga OSHP-ja."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 03/01/2024 ka autorizuar eksperten shqyrtuese për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1055/23, ndërsa me datë 15/01/2024 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/1055 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese, nuk ka dhënë përgjigje, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "KROSA traffic signs" SH.P.K,eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1055 ka vlerësuar si në vijim:

-Konstatimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet e OE ankues: "Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor 1, pasi ka administruar dhe shqyrtuar me kujdes shkresat që lidhen me faktet dhe argumentet në platformën elektronike e - prokurimi, rrjedhën dhe analizën e procedurës për këtë aktivitet të prokurimit të lartë përmendur, për pretendimin ankimor të OE ankues.

Limit & B SH.P.K sipas kërkesës në DT është kërkuar citoj: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: 2. a.) Mjetet e punës ne dispozicion, vetura dhe mjete transporti për kryerjen e punëve b.) Pajisje të punës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimi për shenjëzimin vertikal dhe horizontal, Dëshmia e kërkuar dokumentare: Te sjell dëshmi për Së paku një (1) Kombi, duke u bazuar në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një makinë/mjet transporti të tipit Renault Kango të viti 2004, pasi që AK nuk ka specifikuar saktë kapacitetin peshën (tonazhin), dhe duke e parë që vlerësimi i ofertave është përgjegjësi e AK –së për mendimin e ekspertit ky pretendim ankimor është pjesërisht i qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues jep mendimin e tij në lidhje me pretendimin ankimor 2: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, eksperti shqyrtues konstaton se sipas kërkesës së AK në DT tek pjesa Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar tek Dështmia e kërkuar dokumentare: Një rimorkio me drita sinjalizuese për sigurinë ne komunikacion (Librezat e regjistrimit, ose dudat doganor) për të gjitha të jenë valide ose kontratën mbi qiranë. Pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimor në platformën elektronike OE ka ofruar një marrëveshje bashkëpunimi për shfrytëzimin e kësaj pajisje, marrëveshje bashkëpunimi është e lidhur mes Limit L&B SHPK dhe FAMIS HC, marrëveshja në fjalë përmban elementet kryesore si emrin e projektit numrin e prokurimit për projektin në fjalë, po ashtu ka ofruar edhe DUD doganor për pajisjen në fjalë. Andaj, për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm. Po ashtu bëj të ditur se ky pretendim është sqaruar në ankesën me OSHP: 2023/0295.

Pretendimi ankimor 3 po ashtu ka të bëjë me pjesën: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, a. Makinë për lakimin e metaleve profileve edhe tek kjo kërkesë/dështmi nuk është në mënyrë të specifikuar po e ka len si kërkesë të hapur dhe për mendimin e eksperti shqyrtues ky pretendim është i pa qëndrueshëm sepse OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një makinë prerëse të aluminit.

Pretendimi ankimor 4 po ashtu ka të bëjë me pjesën: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale a. Makinë për lakimin e metaleve profileve, OE i rekomanduar për kontratë në sistemin elektronik në ofertën e tije ka ofruar një marrëveshje bashkëpunimi mes Limit L7B dhe Gyner Haci B.I dhe një DUD doganor i cili ka këtë përshkrim: Makinë prerës që përdoret për punimin e llamarinës dhe profileve metalike në prodhimin e dyerve dhe dritareve me pjesë përcjellëse RT1530 PLASMA CUTTING MACHINE 1/S. ky pretendim për mendimin e ekspertit shqyrtues është i pa qëndrueshëm.

Pretendimi ankimor 5 po ashtu ka të bëjë me pjesën: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sa i përket kërkesë /dështmisë në DT 9.1 & 9.2 c. Makine (gërshëre) për prerjen e metaleve OE i rekomanduar ka ofruar gërshetat por pasi që nuk është kërkuar nga AK në krekën lloji dhe specifika detale e gërshërëve ky pretendim për mendimin e ekspertit shqyrtues është i pa qëndrueshëm.

Pretendimi ankimor 6 nga OE ankues gjithë ashtu ka të bëjë Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sa i përket kërkesë /dështmisë në DT 9.1 & 9.2 d. Makinë për printimin e shenjave te trafikut ndërsa OE i rekomanduar për kontratë në oferte e tije ka ofruar një DUD doganor për makinën printimi të tipit: makina Printimi “MIMAKI” / Printer cutter CJV300-160 Nr Serik: AV16B162 1 cp dhe për mendimin e ekspertit ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm.

Ndërsa sa i përket pjese së pretendimit ankimor se DUD – i është më ndryshe apo ka ndërhyrje në DUD nuk mund të jap një sqarim apo mendim sepse nuk është në domenin e ekspertit shqyrtues por për çdo dyshim ju mund të drejtoheni tek organet përgjegjëse dhe profesionale në këtë qeshje për këtë pretendim.

Pretendimi ankimor 7 nga OE ankues gjithë ashtu ka të bëjë Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sa i përket kërkesë /dështmisë në DT 9.1 & 9.2 d. Autorizim origjinal (apo kopje e noterizuar) nga prodhuesi ose distributori për shenjat vertikale foljen reflektuese DG, Autoriteti kontraktues me datën: 14.12.2023 përmes Letrës standarde për sqarime të tenderit ka

kërkuar sqarime shtesë nga OE dhe me datën: 18.12.2023 OE i rekomanduar për kontratë ka kthyer përgjigjeje tek për mendimin e ekspertit ky pretendim ankimor është i pa qëndrueshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron pretendimin ankimor 3: sipas kërkesës së autoritetit kontraktues në DT është kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe profesional Pajisje të punës për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimi për shenjëzimin vertikal dhe horizontal (Për sinjalizim horizontal 1. Se paku dy makina për sinjalizim horizontal me ngjyre te thjeshte një komponentë dhe duke e parë pretendimin ankimor pas analizimit dhe verifikimit të ofertës në fjalë konstatojmë se OE ka ofruar pajisjen e tipit: Makinë për shenja të trafikut në rrugë, Marka GRACO Tipi Line Lasser III/5900 sipas DUDI doganor kjo makinë është në pronësi të OE ankues, dhe ka ofrua një marrëveshje me bashkëpunimi me OE Boja, andaj ky pretendim ankimor është i bazuar. Po ashtu bëj të ditur se ky pretendim është sqaruar në ankesën me OSHP: 2023/0295.

Pretendimi ankimor 6 nga OE ankues gjithë ashtu ka të bëjë Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale sa i përket kërkesë /dëshmisë në DT 9.1 & 9.2 OE te disponoj një certifikatë ISO standard 9001 2015, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një Certifikatë ISO 9001:2015 të lëshuar nga Europian Quality ang Safety Control (EQSC) e cila është e motorizuar me numër: LRP nr. 3368/2023, por edhe AK në vendimin e datës: 19.12.2023 potencon se e ka verifikuar në linkun i cili gjendet në certifikatë por nuk është hap nuk ka pas qasje dhe duke e parë se AK ka verifikuar por nuk është hapur por OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar certifikatë të motorizuar, AK – komisioni i vlerësimit ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet të prokurimit AK është dashur të kërkoj sqarime shtese, sikur te kishte do te vepronte edhe me tutje sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së. Andaj për mendimin e ekspertit shqyrtues ku pretendim ankimor është pjesërisht i qëndrueshme.

Eksperti shqyrtues sqaron pretendimin ankimor 10: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimit ankimore, konform neni 61 të LPP –së lidhur me Tenderët Jo-Normalisht të Ulët. Pra çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, AK konsiderohet i ulët në 5 pozicione (pozicioni: 16,17,18,19,20), duke ju referuar neni 61 të LPP –së kjo mbetet në përgjegjësi të plotë të Autoritetit Kontraktues dhe është përgjegjësi dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit dhe zyrtarit përgjegjës të prokurimit - ZPP. Duke u bazuar në pretendimin ankimor dhe faktet në fjalë për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "KROSA traffic signs" SH.P.K**,** Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertes shqyrtuese. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se ankesa e operatorit ekonomik ankues "KROSA traffic signs" SH.P.K**, është e** pa bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP,

përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor. Në ketë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në ketë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish. Vlen të theksohet se kjo lëndë në OSHP përësëritet **për herë të tretë,** vendimi i OSHP-se 2023/0295, vendimi i OSHP-se nr. 2023/0637 dhe ky aktivitet në kuptim të nenit 1 dhe në kuptim të nenit 6 të LPP nuk ka nevoj që të prolongohet edhe më tutje.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se ankesa është e pabazuar. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna Viti të datës 08.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit-Ri-tender" me nr. të prokurimit: 657-23-3118-1-2-1.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform rekomandimeve të vendimeve paraprake të OSHP duke kërkuar sqarime shtesë, dhe duke u bazuar në nenet 59, 60 dhe 61 të LPP ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Paneli Shqyrtues vlerëson ky aktivitiet i cili është përcjellur disa herë me ankesa dhe dy herë është kthyer në ri-vlerësim. Andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional konform nenit 59 par. 1 te LPP-së, ku thote: "*Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës*", atëherë në zabim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet i prokurimit edhe më tutje (në pafundësi) dhe duke e pasur parasysh se AK në mendimin e tyre në relacion me raportin e ekspertizës ka deklaruar se është në diskrecion të AK vënia në zbatim edhe e neni 59.4 sa i përket devijimeve të vogla, dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat

personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Njëherit Paneli shqyrtues vuri në zbatim nenin 1 dhe 6 parimin e ekonomicitetit, si një nga parimet kryesore të nenit 104 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, me ç'rast konstatohet në mënyrë jo kontestuese se oferta e OE të rekomanduar për kontrate konsiston në një çmim dukshëm me të lirë me poentim në raport me ofertën e ankuesit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL VITI**
- OE - **" KROSA traffic signs " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: